

AKTI I THEMELIMIT
I
SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
EVS SOLUTION Sh.P.K

Sot në datën 30/10/2023, në Tiranë në Selinë e Shoqërisë me adresë Rruga Him Kolli 45/4, Tiranë, unë, Rashad Baghirov, i biri i Ahmedaga dhe Khuraman, i datelindjes 07.09.1977, lindur në Azerbajjan mbajtës i pasaportës me nr C00799730, madhor dhe me zotesi të plote juridike për të epruar, shpreh vullnetin tim të lirë për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë EVS SOLUTION si më poshtë:

NENI 1
EMRI

1.1 Shoqëria tregtare private me përgjegjësi të kufizuar emërtohet **EVS SOLUTION sh.p.k**, e cila këtu më poshtë do të quhet "Shoqëria".

NENI 2
FORMA

2.1 Kjo Shoqëri është një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3
BAZA JURIDIKE

3.1 Shoqëria krijohet në bazë të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij akti themelimi. Ajo e fiton personalitetin juridik pas rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 4
SELIA

4.1 Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë, Rruga Him Kolli 45/4.

4.2 Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të Asamblesë së Ortakëve.


NENI 5
TERRITORI

5.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin si në territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu edhe jashtë saj. Shoqëria mund të krijojë degë (filiale) ose përfaqësi, si në rrethet e ndryshme të Republikës së Shqipërisë ashtu edhe në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

NENI 6
OBJEKTI I VEPRIMTARISË

6.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

Zhvillim dhe menaxhim projektesh informatike; projektim, programim dhe dizajnim të faqeve të internetit; projektim dhe shitje të sistemeve kompjuterike dhe software drejt bizneseve dhe konsumatoreve brenda dhe jashtë vendit; zhvillime aplikacionesh të ndryshme; tregtim dhe mirëmbajtje të sistemeve kompjuterike, informatike, pajisje kompjuterike,



elektronike, rrjete kompjuterike etj. Sherbime dhe konsulence informatike ne biznese dhe individe brenda dhe jashte vendit. Perfaqesi te kompanive te huaja per produkte dhe/apo sherbime te cilat lidhen direct apo indirekt me shoqerine; import/eksport dhe shitje pajisjesh kompjuterike, elektronike, informatike, audiovizive etj. Promovim dhe marketing nepermjet email, facebook, google, Instagram etj. Prodhim, zhvillim, programim ne sisteme te ndryshme, shitje, blerje, dhenie me qera e software dhe database te ndryshme etj.

Për kryerjen e aktivitetit të shoqërisë së mesipërme, për te cilin do të nevojitet leje përkatëse, shoqëria është e detyruar të pajiset paraprakisht me këtë leje nga organi kompetent.

NENI 7 **KOHËZGJATJA**

7.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhe pa afat, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim te ortakut te vetëm.

NENI 8 **KAPITALI I SHOQERISE**

8.1 Kapitali Themeltar i Shoqërisë tregtare është **10.000 Leke (dhjetemije Leke)**. Ky kapital është i ndare ne 1 kuote dhe vlera nominale e nje kuote eshte **10.000 Leke (dhjetemije Leke)**. Ortaku i vetem eshte zoteruesi i te gjithë kuotave te shoqerise, ne vleren 100% te tyre tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga Ortaket e Shoqerise.

NENI 9 **ORTAKU I VETEM**

9.1 Ortaku i vetem ushtron kompetencat qe ligji i jep Asamblese se Ortakeve.

NENI 10 **ADMINISTRIMI**

10.1 Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga një administrator. Administratori i pare i Shoqërisë është z. Rashad Baghirov.

NENI 11 **SHPERBERJA DHE LIKUIDIMI**

11.1 Shperberja dhe likuidimi i shoqerise tregtare mund te vije ne cdo kohe dhe per cfare do shkakut ligjor, duke perfshire dhe falimentimin, privimin per te ushtruar profesionin tregtar, force madhore, lufte dhe cdo factor tjeter qe nuk varet nga vullneti i ortakut te shoqerise.

THEMELUESI

Rashad Baghirov

Rashad Baghirov